



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE *MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40, al. 2, të Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 14/80) dhe nenit 9, të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit mbi tokën ndërtimore (“Gazeta zyrtare e Kosovës” nr. 42/86), nenit 3, të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19, të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 20.02.2004 merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT-LABORATORIT PËR KONTROLL TË CILËSISË SË BARNAVE NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit-Laboratorit për kontroll të cilësisë së barnave në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 2805, Komuna Kadastrale Prishtinë, fleta poseduese nr. 10316, në sipërfaqe përafërsisht prej 10 ari, në kuadër të kompleksit të QKU-së.

Lokacioni, nga alinea 1 e këtij neni, i jepet në shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës-Agjencionit për Produkte Medicinale.

Neni 3

Destinimi i lokacionit, i caktuar sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në Planin e ardhshëm zhvillimor urban të qytetit të Prishtinës dhe në Planin rregullativ të atij kompleksi.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për caktimin e kushteve urbanistike-teknike, për rregullimin e hapësirës së lokacionit, nga neni 2 i këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës dhe Drejtorati i Kadastërit, dhe Gjeodezisë i Komunës së Prishtinës, do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi Komunal.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-369 DT. 26.02.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri